



## LETËR KOMITETIT

Të nderuar,

Të enjten për kush e di të cilën herë demonstruat moskuptim të plotë të demokracisë si sistem. Si parti në pushtet në një vend formalisht demokratik, përsëri treguat se aspak nuk mërzhiteni për përgjegjësinë tuaj të krijoni dhe kujdeseni për ambientin demokratik. Përkundrazi, ju dolët me lista në dorë dhe me një film i cili duhej të dëshmonte diçka konspirative. E çka është ajo? Se disa njerëz kanë qenë atje ku paraprakisht kanë lajmëruar se do të jenë! Ne e kuptojmë se përpilimi i listave për likuidim ka rrënjë të thella historike në partinë tuaj që nga formimi i saj. E kuptojmë edhe zbavitjen më të re totalitare të cilën e shpikët kohëve të fundit, e ajo është rekomandimi si të ndiqen apo lexohen mediumet, e ja tani edhe si të kuptohen disa persona në skenën publike. Ashtu siç keni nisur, si duket do të përfundoni me rekomandime për atë se çfarë tapeta dhe perde duhet të ketë qytetari në dhomën e vetë të ndejës dhe çka të blenë për ushqim.

Këtu, zbulohet karakteri i vërtetë i pushtetit të cilin e praktikoni. Shoqëritë në të cilat partia në pushtet i përcakton mediumet dhe e nxitë popullin kundër “armiqve” nuk janë demokratike. Komoditeti juaj me të cilin filluat ti përdorni këto metoda tregon dy sende – së pari, se gjatë sundimit tuaj deri në atë shkallë e keni shkatërruar rendin dhe kapacitetin demokratik, sa që sot mundeni lirisht dhe pa dënim nga opinioni të bëni kësi parada totalitare. Së dyti, qytetarët i trajtoni si fëmijë naiv të cilëve u nevojitet “Udhërrëfyes vmro-ist për fillestare” që të mundën të mbijetojnë.

Ajo që ju nevojitet juve është “Udhërrëfyes demokratik për vmro-ist”, që të filloni ta mësoni demokracinë nga shkronja A. Çka duhet të mësoni zotërinj? Ja disa sende për fillim:

- Në demokraci nuk sundon opozita dhe ajo nuk mundet të jetë fajtores për gjendjen në shtet;
- Në demokraci opozita është e domosdoshme;
- Në demokraci qytetari mundet në mënyrë të organizuar apo të paorganizuar të përkrah ndonjë strukturë politike për të cilën mendon se në momentin e dhënë i përgjigjet qëndrimeve të tij;
- Në shoqëri demokratike pushteti as nuk “rekomandon” medime as nuk jep recepte si të kuptoni persona apo ngjarje të caktuara.;
- Në demokraci, përdorimi i video-materialeve private për qëllime propagandistike pa pëlqimin e atyre që janë incizuar zakonisht paraqet vepër penale.

Ju edhe njëherë dëshmuat se e kemi sjellë vendimin e duhur me praninë tonë në mitingun e opozitës, pasi që pushteti juaj arrogant dhe i pacipë është problemi thelbësor i shoqërisë maqedonase. Republika e Maqedonisë ka shumë probleme më të mëdha se ato kush në mitingun e kujt ka shkuar.

Mos e harxhoni kohën me marrëzira, merrni punoni diçka. Formuloni politika të qarta, zbatoni ligjet, futeni vendin në NATO, filloni bisedimet me BE-n. Përmirësoni arsimin, shëndetësinë, kulturën. Tregoni respekt ndaj sundimit të së drejtës, forconi kapacitetin e institucioneve, dëshmoni se i respektoni të drejtat themelore të njeriut. Ndërpritni iniciimin e fjalës së urrejtjes dhe filloni luftën kundër gjithë llojeve të diskriminimit dhe mos-tolerancës. Tregoni se jeni parti demokratike, e civilizuar e cila e dinë çka donë të thotë politika moderne dhe ne do ta ndërpresim shkuarjen në mitingje dhe organizimin e tribunave!

Roberto Beliçanec, Mersel Bilalli, Nikola Gelevski, Branko Geroski, Vladimir Milçin, Zharko Trajanoski